



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 20/2010

Prishtinë më 18. 05. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Zef Morina, Qamile Morina, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Murselj Haljilji, Muferra Şinik dhe Nerxhivane Dauti.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Tmava, Ibush Jonuzi, Zenun Elezaj dhe Naser Peci – KPMM, Dritan Gjonbalaj – AAC, Besim Zeqiri – ICO, Isuf Zejna – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të 05 dhe 11.05.2010;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2009;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja – Propozoi që në rend dite të përfshihet shqyrtimi i procesverbalit të 05. 05. 2010, si dhe para pikës së tretë të rendit të ditës të shtohet shqyrtimi i Raportit - shtesë vjetor 2009 të KPMM - së, ndërsa pika e tretë radhitet si pikë e katërt e rendit të ditës.

Propozimi i kryetares u miratua nga Komisioni.

2. Miratimi i procesverbaleve të 05 dhe 11. 05. 2010

Sala Berisha – Shala – Tha se ka vërejtje në procesverbalet e dy mbledhjeve të fundit dhe vërejtjet e saj do t'i dërgojë më shkrim te stafi mbështetës. Po ashtu kërkoi që pas hartimit të procesverbalit t'i dërgohet anëtarëve në formë elektronike.

Procesverbalet e mbledhjeve 05 dhe 11. 05. 2010 u miratuan më vërejtjet e paraqitura.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2009

Kryetarja – Theksoi se sot i pranishëm në Komision është përsëri Bordi i KPMM- së, që po ashtu ka sjellë “Aneks Raport” rreth pyetjeve të Komisionit, të paraqitura në mbledhjen e kaluar.

Ahmet Tmava, (Kryetar i Bordit të KPMM- së) – Theksoi se janë dhënë gjitha informacionet e mundshme në bazë dhe çdo gjë që ka ndodhur në KPMM, në bazë të kërkesave të Komisionit dhe më materialin e bashkëngjitur si anekse do t'i sqarojnë të gjitha dilemat e ngritura.

Sala Berisha - Shala – Theksoi se këtë shtyrje të Raportit dhe me kërkesë në Aneks Raport i kemi parë përgjigjet. Unë do të rezervohem dhe do ta jap vizën që ky raport me këtë aneks të shkojë në seancën plenare. Për mua dalin edhe shumë pyetje të tjera dhe në këtë rast nuk do ta kisha malltretuar KPMM- në dhe do të jenë raste që dikush tjetër do të vazhdojë punën e vet. Mirëpo, si do që të jetë, është mirë që është kërkuar ky aneks raport, sepse së paku te unë disa nga dilemat janë hequr. Për shembull: po nisem nga pyetja e parë, që ka qenë se sa po zbatohet plani i guroreve të Kosovës? Thuhet këtu se Qeverisë i është dërguar, më 9 gusht të vitit 2007, aneks - shkresa e cila duhet ta fitojë fuqinë ligjore. Prandaj këtu vjen një pyetje, përkatësisht për ministrin e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave se a është bërë i plotëfuqishëm ky dokument? Këtu thuhet se ky dokument po zbatohet vetëm në komunën e Kaçanikut përgjatë magjistrales Prishtinë – Shkup. Jemi dëshmitarë, tjetër efekt produktiv të matjeve ajrore gjeofizike nuk po shihet. Ajo është diçka tjetër, mandej ka qenë një pyetje lidhur me zonat të shpallura me interes nga Qeveria, se ka qenë një pyetje: a keni pasur aplikacione për ato zona edhe a keni

lëshuar licenca? Përgjigjen e kemi marrë se nuk ka licenca për ato zona. Personalisht për mua ka qenë pyetja: a ka pasur aplikacione, sepse njerëzit nuk e dinë a janë zona me interes apo nuk janë, si dhe a janë duke bërë kërkesa për licenca? Një tjetër pyetje se çka keni marrë prej linjimit të Dukagjinit? Këtu është përgjigjja nga ana e KPMM- së se një pjesë të bazenit të Dukagjinit ka pasur licencë të hulumtimeve, thotë kompania e boksive të Kosovës, e cila më vonë thotë për licencë – përmbajtje, kërkesa është miratuar në gusht të vitit 2007. Kjo tash është ndeshur edhe me rregulloren, sepse licencat për minerale energjetike e parasheh që të jenë me tender, d.m.th. me proces konkurrues, ndërsa këtu shihet se është lëshuar një licencë hulumtimi për atë tender, është tërhequr dhe ka licencë dhe përmbajtje që do të jetë mirë për Komisionin se çka do të thotë kjo licencë - përmbajtje që është miratuar nga Bordi në vitin 2007. Këtu, në qoftë se ka mundësi ta sqaroni këtë? Te sqarimi i vijës buxhetore, edhe kjo prapë është në vija të trasha, ndoshta kjo do të jetë një indikacion që të merret prapë dikush tjetër me këtë edhe jashtë vendit, pjesëmarrja në konferenca mua me ka interesuar decidivisht: a janë paguar në shkollime private apo publike? Mendoj se kjo ka shumë rëndësi të dihet, me para publike a janë shkolluar në institucione private? Mandej udhëzimi për tantiema, a është në funksion edhe kjo është njëra prej pyetjeve dhe proukupimeve që më kanë interesuar dhe ky është një realitet që është diçka jo e këndshme, sepse është punuar në këtë drejtim të udhëzimit për tantiema, ku ka qenë në grupin punues edhe Ibush Jonuzi. Edhe kjo është një gjë që konsideroj se në bazë të përgjigjeve që i kemi marrë këtu, konsideroj që kjo e ngarkon Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, pse nuk e ka futur në fuqi? Pse nuk e ka miratuar udhëzimin administrativ për tantiema, për të cilat këtu përmendet operatorët e mineraleve metalore kanë bërë kërkesa për shkak të rënies në bursa, sepse në këtë rast i kemi dy operatorë për momentin, Feronikelin edhe Trepçën edhe kjo është një përgjigje. Ju e keni konsideruar si një përgjigje e politikave, kjo d.m.th. që automatikisht zhvendoset nga obligimi i KPMM- së dhe kalon te Ministria dhe kjo ka qenë një e mirë se përgjegjësi e kujt janë, cilat detyra, cilat përgjegjësi i kanë institucionet tona në Kosovë?

Ethem Çeku - Raporti shtesë duket mjaft i detajizuar brenda kornizave të tyre ligjore që kanë sjellë informacione. Mendoj se ne nuk mund të kërkojmë nga KPMM- ja që të jetë çels i të gjithave projekteve, që kanë të bëjnë jashtë kompetencave të saj, të cilën e përmendi edhe Sala, ku një pjesë e tyre dhe në përgjithësi i kanë potencuar dhe adresuar që të kërkohej përgjigje nga Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria e Punëve të Brendshme, që ka të bëjë me pengimin e operatorëve ilegalë dhe shumë çështje të tjera. Po ashtu edhe të tantiemave dhe çështjes së pengimit të operatorëve ilegalë dhe çështje e shumë fenomeneve të tjera, po ashtu edhe çështja e mosfunksionimit, çështja e minierave dhe shumë gjërave të tjera. Mendoj se ne, si Komision, duhet ta mbështetëm këtë raport që është sjellë dhe ta dërgojmë në Kuvend për të diskutuar deputetët dhe grupet e tyre parlamentare. Ata do të fokusohen për ta mbështetur ose për ta kritikuar dhe për të sugjeruar me vërejtjet e tyre brenda kornizave politike të grupeve parlamentare.

Fatmir Rexhepi – Në mandatin e kaluar kur e kemi shqyrtuar, e kemi pasur Raportin vjetor, e kemi pranuar dhe kemi dhënë vlerësime më të mira për Bordin edhe për drejtorin edhe për krejt ekipin e KPMM- së. Ky aneks e plotëson atë edhe unë personalisht nuk e di se çka po kërkojnë më shumë. Mendoj se i ka përmbushur të gjitha ato kritere dhe

rrallë ndonjë Bord raporton në këtë mënyrë, më këtë pedanteri, me këto përgjigje dhe me këtë korrektësi. Prandaj unë vetëm mund të ju përkrah, të ju urojë punë të mbarë.

Zef Morina – Tha se pa dyshim që është njëri ndër Raportet më të detajuara që ka ardhur veçanërisht kur i kemi parasysh këto anekset dhe përgjigjet të cilat janë kthyer pas. Te pyetja e parë, që e kam bërë se si qëndron Raporti i inspektoratit të KPMM- së me inspektoratet e komunave, këtu shihet se është një numër shumë i vogël i inspektorëve, gjë që vërtet është hendikep, sepse situata në terren pikërisht edhe për këtë arsye është alarmante, e veçanërisht po më bënë përshtypje se e bënë ndarjen e pesë rajoneve, e jo më shumë. Kush është ai që do ta bëjë me përkushtim zgjerimin e këtyre inspektorëve, por ka ndonjë instancë e cila e obligon si të veprohet ndryshe, është rajoni i Gjakovës, i cili ka shumë më tepër nevojë për inspektorë në këtë drejtim. Mirëpo si do që të jetë, këtu kishte me qenë mirë një sqarim. Ndërsa në pyetjen e dytë kemi raste të cilat kompanitë, që kanë marrë licencë në hulumtim, kanë punuar edhe në shfrytëzim. Unë kam bërë pyetje: pse ato nuk kanë kërkuar edhe licencë për shfrytëzim, sepse në Raport, që na keni dhënë, ekzistojnë edhe disa kompani që kanë licencë edhe për hulumtim, ndërsa ekziston si kompani që operon, por nuk ka licencë për shfrytëzim edhe kjo më interesoj. Përndryshe e përkrah dhe ju falenderoj për këtë raport shumë të mirë.

Kaqusha Jashari – Tha se atë ditë kur diskutuam për Raportin, e kam parë se është për Kuvend. Mirëpo interesimi ka qenë që të aktivizohet më shumë. Unë kam vërejtje në terren dhe dua ta di se cilat janë kompetencat e obligimeve që janë bërë në këtë lëmi. Ajo çka më ka interesuar për Strezovc, a kanë kërkuar apo jo? Këtu shihet se nuk ka kërkuar licencë kompania Likon LNC – a është kjo kompania e tyre, a është në Strezovc apo ku gjendet? Prandaj e përkrah dhe duhet të shkoj në Kuvend.

Qamile Morina – Tha se kërkoj vetëm një qartësim: Trepça e ka licencën për shfrytëzim apo hulumtim? Prandaj thotë se ka mundësinë pa licencë për shfrytëzim dhe mbasandaj e keni prapë që nuk po i lëshohet licenca d.m.th. qartë a e ka licencë për shfrytëzim apo për hulumtim?

Kryetarja – Theksoi se nëse krahasohet me Raportin e vitit 2008 me këtë të viti 2009 është shumë, jashtë mase i detajizuar, në çdo gjë të mirë apo në çdo problem që ka ndodhur brenda KPMM- së. Unë do ta pranoj këtë raport edhe brenda Komisionit parlamentar edhe do ta votoj, por njëkohësisht edhe në senacën plenare do të votohet ky raport, sepse është më i detajizuar nga KPMM- ja, nga koha që jam duke e udhëhequr këtë komision parlamentar.

Ibush Jonuzi (anëtarë i bordit të KPMM - së) - Tha se në përgjigje të pyetjeve Sala shtroi çështjen e zbatimit të licencave për minerale metalike për zonat me interes: a ka pasur apo nuk ka pasur aplikacione? Mirëpo, ne e kemi zgjeruar në 2485 km katrorë në zonat e interesit, vetëm për këtë pjesën e mineraleve të Trepçës, pa folur për zona të tjera, d.m.th. askush nuk ka shans. Ne i kemi sugjeruar Ministrisë që të zgjerohet zona e fushave me interes, në mënyrë që askush të mos ketë mundësi të hyjë aty. Tashti është shumë e sigurt ajo çështje. Zbatimi i planeve të guroreve me përpikëri zbatohet 100 % në pjesën e Kaçanikut. Arsyeja është shumë e qartë, këtu është edhe Zefi, që është ekspert i

asaj fushe, nuk guxojmë të lëshojmë pe asnjë milimetër aty, sepse nëse ndodh ndonjë rrëshqitje, ne mbajmë përgjithësi, kurse në zona të tjera mund të ketë lëvizje shumë të vogël. Mirëpo ka lëvizje, prandaj ne duhet me qenë shumë korrekt para jush, d.m.th. në pjesën e Kaçanikut nuk ka asnjë milimetër ai aplikues, i cili nuk hyn brenda fushës së planit të gurorëve, nuk mund të marrë as licencë për hulumtim, as licencë për shfrytëzim. Çështja e linjtit të Dukagjinit, të drejtë keni se rregullorja 2005/3 që tani shpresojmë që ka për t' u larguar prej fuqisë Ligji për miniera dhe minerale, kur shuarja e licencave kur nuk ka qenë kjo rregullore në fuqi është punuar atëherë ashtu apo nuk ka qenë çështje e jona po e ka bërë dikush, por tash nuk ka licencë. Tantiema mund të them se është çështje e Ministrisë, ne e kemi mbaruar krejt, mirëpo ministria duhet ta iniciojë këtë çështje që ajo të futet në zbatim. Ne kemi biseduar ende pa ardhur në Komision, sepse është shumë e nevojshme të hyjë në funksion ai draft. Ne që kemi qenë pjesëmarrës, mendoj se ka qenë një spektër shumë i gjërë kur është hartuar ajo listë e tantimave për Kosovë. A ka pasur financim vetëm në sektorin publik apo edhe ne atë privat, unë them se ka pasur edhe në njërin edhe në tjetrin dhe mund të them se është shumë përgjigje e shkurtër. Pyetja tjetër që u shtrua është problem shumë i madh për çështjen e inspektoratit. Ne nuk kemi kapacitet për ta shpërndarë në të gjitha zonat, por është përfshirë në pesë zona, sepse numri i inspektorëve që janë në KPMM është i vogël dhe për atë po them se nuk ka kapacitet më të madh. Ne pas takimit atë ditë kemi shkuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe kemi biseduar edhe me autoritetin e ATK- së. Ata janë zotuar se kanë për ta mbështetur. Mendoj se jemi në rrugë të mirë, mirëpo mund të them se nuk kemi pasur kurrë mundësi të gjitha për t'i eliminuar, për ta zvogëluar numrin e operatorëve ilegal, sepse është detyrë shumë e madhe t'i ndalojmë të gjitha se çka është duke ndodhur. Por mund të them se nuk është e gjitha përgjithësi e KPMM- së, çështja e shfrytëzimit të zhavorreve është 99% kompetencë e Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Ne, si KPMM, jemi në gjendje ta zbatojmë pjesën e cila neve na përket. Te licenca e hulumtimit, pastaj shfrytëzohet edhe për shfrytëzim, ato minierale ndërtimore që shfrytëzohen pa eksploziv e pa minim, ka mundësi edhe kjo të bëhet. Mirëpo ne në momentin që identifikohet që një kompani e tillë, atëherë ne menjëherë ia dërgojmë shkresën dhe në veprimet e tilla duhet t'i merret edhe licenca menjëherë për hulumtim d.m.th. ku përdoret eksplozivi nuk ka shanse, ndërsa ka mundësi për të bërë edhe atë në veprim. Sa i përket Strezovcit më ka interesuar vet se çfarë pasurie po shfrytëzohet. Ne ju kemi dhënë licencë për hulumtim, mirëpo në momentin kur ata kërkojnë licencë për shfrytëzim, menjëherë jemi të padurueshëm, në mënyrë që të shfrytëzohet ajo pjesë e Dardanës (Kamenicës). Për çështjen më të ndjeshme për Trepçën, sepse ajo është në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, e dimë të gjithë, ne kemi punuar shumë, në mënyrën më të mirë të mundshme për ta gjetur për lëshimin e licencës për shfrytëzim, por e kanë Staritërgu, Artana, Cërnaci dhe Novobërda. Këto kanë licenca për shfrytëzim, mirëpo duke punuar me taks forca, që është bërë tash prej Qeverisë së Kosovës, kryetari i Bordit është kryetari asaj taks force, edhe unë kam marrë pjesë se kam qenë mjaft i lidhur me Trepçën, sepse është dashur të gjendet mënyra më e mirë e mundshme, çka të bëhet për të dalë para jush. Unë mund të them se e vetmja formë për të shkuar përpara është nxjerrja e një ligji vetëm për Trepçën. Me Ligj rregullohet çështja, se ata për momentin nuk kanë asnjë pengesë për shfrytëzim, sepse është ajo licencë ose vendim që ju ka lëshuar dhe nuk mund ta kontestojë as gjykata, as dikush tjetër.

Sala Berisha - Shala – Pyeti: a është pengesë moratoriumi dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për Trepçën për mos me i dhënë licencë për kohëzgjatje?

Ahmet Tmava (Kryetari Bordit të KPMM- së) – Tha se ky është vendim i jurisë, vendimi i ndërmjetëm është shuar për shkak të rrethanave. Mirëpo për ta marrë një licencë të përhershme afatgjate Trepça duhet të bazohet te Ligji i Minierave. Po punojmë në përgatitjen e këtij dokumentacioni, që në momentin e miratimit edhe të Ligjit të minierave Trepça të shkojë në një licencë shumë më afatgjate, kështu që brenda vitit të shkojë, sepse ne jemi mjaft të harmanizuar me Trepçën.

Sala Berisha Shala – Tha se përderisa Gjykata Supreme e ka një dhomë të veçantë, e ka një vendim në moratorium në bazë të rregullores 2005/48, mendoj se Trepçën e vë në një ombrellë ndaj kreditorëve, në një formë është një pengesë e zhvillimit të saj të mëtutjeshëm, atëherë me këtë shërbehet edhe KPMM- ja dhe mendoj se është dashtë të vlejë për të gjitha asetet e saja, është dashtë të vlejë edhe për Çukën e Batllavës. Në këtë rast, që u lëshua një licencë mendoj se është aset i Trepçës. Mua po me duket se me një anë po shërbehemi me situatën de jure për shkak të moratoriumit, në anën tjetër i lëshohet një licencë në një aset të Trepçës edhe de jure edhe de fakto më duket një situatë pak kontraverze.

Ibush Jonuzi (anëtarë i bordit të KPMM- së) – Tha se vetëm edhe një fjali të çështja e rregullores 2005/48, që e thash, duhet të shfuqizohet ajo rregullore, sepse është pengesa numër një.

Ibush Jonuzi (anëtarë i bordit të KPMM-së) - Tha se ne e kemi biseduar edhe çështjen e Çukës së Batllavës në task forc, prandaj askujt nuk i lëshojmë licencë pa e pasur pëlqimin e pronarit, d.m.th. jo për një Trepçë, as për një Drazhnje, as për Artanën, e Staritërgun, as për një gurore nuk e lëshojmë licencën pa e pasur pëlqimin nga pronari. Për shembull Bejta Komercit të gjithë e dimë që është një kompani mjaft rentabile që e bën shfrytëzimin materialit ndërtimor, operon për momentin në një fushë të miniera e Kishnicës, aty ka qenë stacioni i kompresorëve. Mirëpo ne kemi kërkuar pëlqim nga Trepça për t'ia vazhduar licencën për shfrytëzim edhe deri në të gjashtin muaj e ka kontratën. Ne ia kemi dhënë mundësinë të operojë dhe si të kalojë koha mbas gjashtë muajve bie poshtë pëlqimi nga pronari. Nga Trepça licenca i tërhiqet d.m.th. për ata jemi shumë të kujdesshëm.

Pas debatit të gjerë Komisioni më 6 (gjashtë) vota Për dhe 1(një) Kundër nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2009

dhe paraqet këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës ta mbështetë Raportin e punës njëvjeçare 2009 të

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC për vitin 2009
Kryetarja e ftoi përfaqësuesin e Autoritetit të Aviacionit Civil që ta paraqesë Raportin vjetor për vitin 2009.

Dritan Gjonbalaj, (Drejtori i AAC- së) – Për herë të parë Autoriteti Civil i Aviacionit raporton para jush. Unë do të mundohem që në vija të trasha të paraqes këtë raport. Më 13 mars të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, përveç tjerash, themelon Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Për punët dhe përgjegjësitë e AAV- së do të flitet më hollësisht më tej në këtë raport. Deri me hyrje në fuqi të Ligjit për Aviacionin Civil kjo fushë ka qenë kompetencë e rezervuar e UNMIK- ut. Këto kompetenca UNMIK- u i ka ushtruar përmes ish - Zyrës Rregullatore të Aviacionit Civil (ZRRAC). Ministri i MTPT- së, në bazë të Nenit 101 të Ligjit për Aviacionin Civil, me qëllim të tranzicionit sa më të lehtë në bartje të kompetencave nga UNMIK- u në institucionet e Republikës së Kosovës e ka autorizuar ZRRAC - in t'i ushtrojnë funksionet e AAC- së deri më 31 dhjetor 2008. Në atë kohë ishte planifikuar që AAC- ja të bëhej plotësisht funksionale më 1 janar të vitit 2009- të. Kjo është realizuar, AAC-ja është vetëm njëri nga autoritetet publike me përgjegjësi dhe funksione në fushën e aviacionit civil në vendin tonë. AAC-ja është Agjenci e pavarur, rregullator e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. AAC-ja udhëhiqet nga drejtori i përgjithshëm. Drejtori i përgjithshëm i AAC-së është emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr 06/37 të datës 25 shtator 2008. Puna e AAC- së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës prej pesë anëtarësh. Inspektorët e AAC- së kanë kryer inspektime dhe auditive për të garantuar që operimet e aviacionit civil në Kosovë, kryhen në përputhje me standardet në fuqi. AAC-ja ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet e tjera përgjegjëse për aviacionin civil në Republikën e Kosovës, në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. AAC-ja ka nënshkruar Memorandum mirëkuptimi me MPB- në, me të cilin merr përsipër asistimin e personelit të MPB- së në fushën e sigurimit të aviacionit civil, derisa sektori përkatës në MPB të jetë i përgatitur plotësisht për kryerjen e detyrave që ia përcakton Ligji. AAC- ja ka qenë mjaft aktive në bashkëpunim ndërkombëtar në aviacion civil duke përfshirë bashkëpunimin me BE- në, shtetet anëtare dhe shtetet e rajonit. Përfaqësues të AAC- së kanë marrë pjesë në iniciativat e bashkëpunimit rajonal në fushën e aviacionit. Këtu përfshihet pjesëmarrja e AAC- së në mbledhjet e organizuara nga Komisioni Evropian në kuadër të projektit të implementimit të Marrëveshjes mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe në takimet dhe në takimet e organizuara nga Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit. Sektori i financave ka bërë mbylljen e vitit fiskal sipas procedurave të parashikuara me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Në këtë raport paraqitet edhe pasqyra financiare dhe aktivitetet e prokurimit të AAC-së për vitin 2009.

Zef Morina - Ky është një raport dhe një sqarim shumë i qartë, shumë i drejtë dhe mund të them në atë kuptimin esencial. Të gjitha ato që i thatë janë inkurajuese se situata me

Kosovën në këtë lami ka qenë vërtet shumë e rëndë. Ne e dimë si ka qenë situata menjëherë mbas lufte. Pastaj si ka vepruar Drejtorati i aviacionit në kuadër të UNMIK-ut, mënyra si ka operuar dhe kompetencat si janë deleguar dhe ka pasur shumë probleme. Mirëpo për fat të mirë njerëzit tanë, djemtë tanë, kanë arritur që të profesionalizohen dhe në këtë mënyrë pak me vonesë janë bartë kompetencat, ku kanë mundur të barten para se të shpallet shtet i pavarur Kosova. Mirëpo sido që të jetë mjafton kjo, që të jenë të gjitha kompetenca të njerëzve tanë. Pyetjen që desha ta bëj në njëfarë mënyre ju e dhatë përgjigjen. Mirëpo prapë po e parashtrojë një pyetje: deri kur do të jetë kjo hapësirë ajrore mbi 10 mijë metra e mbyllur? A ka ndonjë afat kohorë dhe a jeni të përgatitur që këtë hapësirë ajrore ta keni nën kontroll? Me qenë se, siç thatë edhe ju, është një numër mjaft i madh i fluturimeve e që do t'i kishin sjellë të ardhura të mëdha Kosovës, janë mbi 250 ose edhe më shumë dhe dihet se sa është çmimi i tyre. Vërtet kishte me qenë mirë, në njëfarë mënyre, nëse jemi të përgatitur teknikisht. Duhet të jesh teknikisht i përgatitur në mënyrë që edhe politikisht ta kishe një vijë pozitive. Në IKO, qysh kur kam qenë unë, është biseduar kur në atë kohë UNMIK-u e kishte nën kontroll. Është biseduar që Kosova do të jetë anëtare e IKO – së, sepse nuk ka pengesa qoftë ligjore qoftë juridike, por thjesht duhet me qenë një angazhim më i madh, sepse kjo më tepër është politike dhe në këtë drejtim mendoj se ka ngecje. Këtu duhet të përdoret shumë me vendosmëri dhe është fat i mirë që në Kosovë nuk kanë ndodhur aksidente vetëm në vitin 1999 – të, nëse nuk gaboj një aeroplan është rrëzuar duke u kthyer nga Italia. Këtu në platformë ka shumë pak aeroplanë, sa jam në dijeni. Më duket se janë një apo dy, të cilët fluturojnë natën, nuk kthehen, e kontrollimin teknik ose inspektimin e tyre ju e keni dhënë në raport. Mirëpo mua më intereson se nga kush bëhet dhe a bëhet një inspektim i mirëfilltë apo në rutinë? Është shumë me rëndësi, sepse te ne fluturojnë shumë aeroplanë Charter, të cilët janë të vjetër, nuk kontrollohen nga pronarët e tyre, nuk bëjnë inspektime të rregullta teknike dhe në këtë drejtim përgjegjësia është sigurisht te ne dhe nuk duhet ta kemi parasysh dhe të kujdesemi, që eventualisht të mos vije deri te ndonjë tragjedi. Edhe një pyetje tjetër do të doja ta bëja, duke pasur parasysh pengesën që e kemi nga Serbia dhe nuk kemi të drejtë të kalojmë në territorin e saj. A është punuar në hapjen e korridoreve të reja? Unë para një jave kam udhëtuar në Cyrih edhe nuk i kemi rënë nga kemi fluturuar gjithnjë, d.m.th. i kemi rënë një korridor tjetër. A është vërtet një korridor i ri, apo si është puna? Është shumë mirë që tash është hapur vijë edhe me Podgoricën dhe me Shqipërinë.

Fatmir Rexhepi - Tha se duke u bazuar në Ligjin për aviacionin të autoritetit përkatës edhe Raportin vjetor e kanë plotësuar. Mirëpo në konditën e parë mendoj që kjo të shkojë në debat në Kuvend. Raporti përmban të gjithë historikun gjatë gjithë fazës së tranzicionit marrjes së përgjegjësisë nga autoritetet e tjera në autoritetet vendore, problemet, telashet, ngritja e kapaciteteve, që është një fazë e cila kuptohet dhe nevojat e tjera që shtrohen para këtij autoriteti që të ngiten në cilësi, në siguri etj. Pra, të gjitha ato që i citoj drejtori, e përkrahim këtë vizion, në mënyrë që realisht të përmbushen standardet në fushën e sektorit të aviacionit civil, që ka nevojë vendi ynë, ka nevojë edhe për ato që i tha edhe Zefi, jo vetëm për korridore, por edhe për shkak të fluturimeve të shumta për njerëzit, për çmimet, për të gjithë atë pjesë që e përcjellin dhe që ka mundësi të rregullohet edhe më shumë. Ne duhet ta përkrahim këtë raport normal, mandej vjen pjesa tjetër e problemeve që janë brenda Raportit, të diskutohen me kohë dhe unë mund

të ju them se ju përkrahim.

Ethem Çeku – Tha se realisht është hera e parë që Aviacionit Civil të jetë para Komisionit dhe unë personalisht e përgëzojë për punën e bërë në këtë raport, edhe për të gjitha ato vështirësi që i kanë pasur në periudhën e transicionit. Mua më vjen mirë, posaçërisht për këmbëngulësinë edhe ajo forma që i kanë rrëmbyer çelësat për të menaxhuar dhe për të ecur me një sektor tepër vital dhe tepër të rëndësishëm. Unë nuk kam ndonjë çështje që do të ngriti, mirëpo atë që tha Zefi e lexova edhe më herët në Raport për 450 fluturime edhe mbyllja e hapësirave në aspektin financiar. Ne po kemi telashe se vendin nuk po e administrojmë në shumë fusha, se ne administrojmë edhe fushën e tensionit të lartë të energjisë elektrike. Serbia përdor rrjetin e tensionit të lartë, i shfrytëzon me mijëra euro, dhe as në tokë e as në qiell nuk po kemi shumë hapësirë të demonstrojmë vetë edhe ajo këmbëngulësia juaj që të bëni punë të jashtëzakonshme më vjen shumë mirë. Po ashtu raportet e mira me institucionet ndërkombëtare edhe lufta e juaj për t'u anëtarësuar sa më shpejt në partneritet të barabartë institucional edhe ndërkombëtar, mendoj se jeni duke e bërë një hap shumë të mirë. Besojë se ne, si Kuvend, duhet t'ju japim, në një farë forme, mbështetje, që të arrini e të bëheni pjesë e barabartë me të tjerët. Mendoj se edhe Qeveria edhe institucionet e tjera përkatëse duhet të ju ndihmojnë në këtë fushë. Një problem tjetër që unë nuk kam shumë njohuri se ato përcaktimi i tarifave dhe i çmimeve më duket që s'kam informacion, nëse nuk gabo, se ato janë shumë të shtrenjta për udhëtarët kosovarë, posaçërisht kur e dimë që diaspora jonë është mjaft e varfër, me çmime marramendëse të pagimit. Unë nuk e di se cilat janë mundësitë tuaja në atë drejtim që të ndikoni në lehtësimin e udhëtimit.

Qamile Morina – Theksoi se të hyrat prej 2.4 milionë euro vetëm nga tarifa e hyrje - daljeve paraqiten në Raport, kurse vlerat që ju i veni në të hyrat janë diku 1 milion euro. Tjetra ka të bëjë me aktivitetet e prokurimit për vitin 2009, siç e keni në proces, edhe aty nuk është dhënë vlara e objektit me qira. Pyetja tjetër ka të bëjë për mbrojtjen e udhëtarëve, në të cilën unë besoj që me marrëveshjen e ECAA qëllimi është që të afrohet aviacioni jonë. Pra, ata e kanë atë qëllim që të bashkëpunojnë me ju, në mënyrë që të përafrohet legjislacioni jonë me atë Evropian, sa keni kompetenca dhe sa arrini ta zbatoni duke e ditur faktin që udhëtarët tanë nuk e kanë një çmim fiks të udhëtimeve të tyre? Janë festat, janë pushimet verore, kur udhëtarët tanë për së tepërmi paguajnë ndryshime, variacione të mëdha të çmimeve. Ne e dimë se në qoftë se ju dëshironi të përafroheni me legjislacionin evropian, atje janë rregullat, në atë mënyrë që nëse ju e merrni biletën e 3 deri 4 javë, atëherë ajo është më shumë se përgjysmë më e lirë. Meqenëse ju i bëni politikat e aviacionit civil, sa ju e keni paraparë, sa keni qenë të përfshirë në çështjen e koncesionimit të aeroportit?

Kaqusha Jashari - Ishte e interesuar të dije për trajnimin e personelit të aeroportit, për sistemin e ri të funksionimit dhe tani me çështjen e koncesionit, ndoshta nuk është tema tamam, sepse Raporti është për vitin 2009, ndërsa tani jemi në 2010- ën. Mirëpo po më intereson kontrollimi i firmës, e cila do të fitoj ose e ka fituar koncesionin në aeroport? A duhet ndaj tyre diçka e veçantë me qenë? Ndonjë marrëveshje është në kuadër të atij tenderi? A do të jetë obligative që këta të aftësojnë kuadrot tona edhe më vonë kush do t'i aftësojë? Pastaj pyeti për korridoret ajrore. Pastaj tha se a do të luftoni ende në

përmirësimin e kushteve? Çka janë ato mes nesh dhe atyre që fitojnë koncesionin? A do të vazhdoj një angazhim i tyre? Sa ka qenë deri më tani apo janë disa shpenzime pak të mëdha për të cilat duhet të merret nga kjo firmë, që e ka marrë aeroportin në shfrytëzim me koncesion?

Sala Berisha-Shala – Tha se është hera e parë që ky Autoritet i raporton Kuvendit. Ajo që është për t'u përmendur dhe që mua më ka bërë shumë përshtypje për të mirë është vendosmëria e stafit të Aviacionit Civil që, siç e përmendët, t'i rrëmbejnë çelësat, por edhe vendosmëria e tyre për të ecur përpara. Përmendet diku në Raport se edhe pse nuk kemi qenë të njoftuar rreth pjesëmarrjes në trajnime të ndryshme, në konferenca e takime të tjera, iu kanë imponuar, në njëfarë forme, atyre takimeve që për mua e ka domethënien e madhe, sepse te ta ekziston një besim, por nuk mjafton të jetë vetëm besimi, por e kanë edhe guximin që të shkojnë përpara. Kjo është një tregues i mirë i asaj se nëse dëshirojmë të arrijmë në cak, së pari duhet që të besojmë në atë cak, e pastaj duhet t'ia mësyjmë guximshëm atij. Në faqe 20, te marrëveshja me hapësirat e përbashkëta evropiane të aviacionit, parashtron një varg kushtesh për vendet e rajonit të Ballkanit dhe kjo është një pjesë që të inkurajon, sepse Kosova është në prag të kalimit të parë, pra fazës së parë, si dhe përmendët që pritet dy kritere të plotësohen dhe në qoftë se nuk e kam gabuar, njëri prej kriterëve është edhe ligji i punës, të cilin ne e kemi marrë si deputetë, si draft ku shpresoj se së shpejti do të procedohet në Kuvend dhe së shpejti do ta plotësoni këtë kriter. Ne do të jemi ata që do ta shtyjmë, do ta kërkojmë amendamentimin sa më të shpejtë të mundshëm në mënyrë që të kalohet edhe kjo provë. Pastaj në faqe 34 kemi taksa ilegale, dhe më rëndësi është një element që ekipi, përkatësisht punëtorët e aviacionit civil, janë shumë të vëmendshëm edhe në këtë drejtim. Kjo taksë është vendosur për ata udhëtarë që i kanë rezervuar biletat në formë elektronike. Është eliminuar edhe kjo pengesë, sepse edhe kjo tregon atë vendosmërinë e mëtutjeshme. Këtu sigurisht është e vendosur një gabim teknik, faqe 35, thotë: 5 reagimet e aviacionit civil më 8 dhjetor 2010, me seli në Gjenevë. Pra është 2009. Është për ta përshëndetur, e mbështes dhe e përkrah këtë raport.

Kryetarja – Tha se pikë së pari ju përgëzoj për një raport të tillë. Duke e marrë parasysh se Raporti ka rëndësinë e vet dhe njoftimi i deputetëve, të cilët mund të jenë në trupa politike, por jo të gjithë mund të jenë ekspertë të një fushe të caktuar. Mirëpo është fat i Komisionit që i kemi tre ish - Ministra të linjave të caktuara dhe ndoshta në mungesë të informacionit të ndonjërit prej deputetëve, këto na bëjnë të mundur të kuptojmë diçka që nuk kemi ditur. Mund të them se i gjithë Raporti është një pasqyrë e mirë e njoftimit tonë, në bazë të Ligjit të Aviacionit Civil, i cili ka ardhur me Pakon e Presidentit Ahtisaari. Ende mbetet shumë punë, sikurse që ka edhe e gjithë Kosova shumë punë, edhe ju keni shumë punë, sepse është një pjesë shumë më rëndësi, në të cilën duhet të punohet shumë. Unë vetëm në 2 pika kisha për t'i potencuar: çështja e rregullimit ekonomik dhe aktivitetet tjera rregullatore në fushën e aerodromeve. Këtu ndoshta duhet një punë pak më tjetër. Uroj që të gjitha këto hapësira të mbyllura ajrore të jenë të zhbllokuara, si dhe uroj që të keni vullnet më të madh dhe të mblidhni afër vetes kuadrot më të mira, sepse është një Agjenci që duhet të ketë një numër të madh të ekspertëve.

Dritan Gjonbalaj (Drejtori i AAC- së) – Tha se ndihet shumë krenar me fjalët që i

thanë sot. Në pyetjet u përgjigj: Hapësira ajrore është mbyllur nga NATO-ja në vitin 1999, menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Qeveria jonë, institucionet tona, i kanë kërkuar AAC-së që, në nivelin teknik, të fillojë, ta përcjellë kërkesën për hapjen e hapësirës së lartë ajrore. Edhe nga kompanitë ajrore ka gjithashtu presion të madh, sepse ata e duan rrugën më të shkurtër, si dhe rruga mbi Kosovë është një rrugë tradicionale. Prandaj dhe janë 450 fluturime, pra diku 100 euro një fluturim për të mbikaluar, pra pak a shumë një shumë, por varet edhe prej peshës së aeroplanit se sa është i madh, nuk ka një afat kohor të caktuar. NATO-ja ka krijuar një panel teknik në kuadër të asaj që quhet Mbledhja për Normalizimin e Hapësirës Ajrore të Ballkanit, a kemi kapacitete? Kapacitetet duhet të jenë te Kontrolli i Trafikut Ajror, i cili është një entitet krejtësisht tjetër prej nesh. Në këtë kuptim, po themelohet Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror dhe besoj që shumë shpejt do t'ju vijë edhe drafti i ligjit me Koncesionimin e Aeroportit ku do të ndahet Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror, si Agjenci e shtetit, pra nuk do të jepet në koncesion. Ministria e Transportit e ka hartuar një draft që, mua si ekspert, më është dukur shumë i mirë. Tani gjendet në Komitetin Ndërmnistror, në një Grup Ndërmnistror. Rreth inspektimit të aeroplanëve në platformë ju them që i kemi dy pilotë të linjave të cilët punojnë në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe tre inxhinierë të trafikut ajror, të cilët tani më janë bërë magjistra për shkak të sistemit të Bolonjes, që gjithashtu janë trajnuar pikërisht në inspektimet e aeroplanëve në platformë në Holandë dhe në Gjermani. Kisha dashur që t'ua heq shqetësimin se pa marrë parasysh se a është "Charter" apo jo, shteti ku ato janë të regjistruara i kanë strikte kriteret e sigurisë. Është e vërtetë që brenda mund të jenë më të ngushtë për më shumë njerëz, mirëpo sa i përket çështjeve të sigurisë, të gjitha këto kompani kanë një certifikatë për veprime ajrore në shtetet ku janë të regjistruara dhe ne jemi këtu që t'i inspektojmë çdo ditë që publiku të udhëtojë i sigurtë. Po e marrim një pjesë të kreditit edhe ne si AAC ku kemi bërë presin mbi AAC të Malit të Zi, me logjikën se si mund të lejoni ju si shtet që hapsirën tuaj ajrore ta kontrollojë ende Serbia. Pra ka intervenuar Qeveria e Malit të Zi që të lejohet fluturimi mbi të nga Kosova. Memorandumi shpjegues është bërë që në vitin 2008, pra edhe në kohën kur kemi punuar me UNMIK-un, ne kemi mbajtur lidhje me njerëzit tanë. I është dërguar Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe besoj që jemi mirë, mirëpo na kanë thënë që të pritet momenti i caktuar. Ne si trup, rregullator teknik, natyrisht që nuk kemi kurrfarë kompetence, pra është në nivelin ekzekutiv dhe në nivelin tuaj. Tarifat, çmimet e udhëtarëve? Kështu që për të mos e elaboruar gjatë, nuk është përgjegjësi e AAC-së por është përgjegjësi e dikujt tjetër. Sidoqoftë ekzistojnë rregullore që janë transfuzuar nga Komisioni Evropian. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, si rregullator ekonomik i transportit ajror, e ka edhe çështjen e tarifave. Mirëpo mundësia e intervenimit në tarifa është pothuajse inekzistente, pikërisht me legjislacionin. Por kjo nuk është në domenin tim. Gjithashtu e përmendët çështjen e të hyrave, keni shumë të drejtë mbase unë nuk kam qenë shumë i qartë në raportin tim, mirëpo taksa prej dy eurosh vilet në udhëtarë që nisen nga Aeroporti. 1 milion e 200 janë vajtje-ardhje. Nisje në aeroport kanë qenë diku 550 mijë dhe nga kjo taksë përjashtohen fëmijët deri në 2 vjeç. Pra taksa aplikohet në pasagjerët që nisen nga Aeroporti i Prishtinës e jo në ata që vijnë. Besoj që për të gjithë është lajm i mirë hyrja shumë shpejt tash në treg e "EASYYET".

Qamile Morina – Pyeti njerëzit tanë që vijnë nga Zvicra e Gjermania, a paguajnë taksë

kur të shkojnë nga Kosova?

Dritan Gjonbalaj (Drejtori i AAC-së) – Tha se paguajnë. Janë të paraqitura shumë saktësisht në Raport. Ai është një person. Ai mund të vijë dhe të shkojë, por është një person. Kemi qenë të përfshirë, sepse ofertuesit potencialë kanë bërë një numër të madh pyetjesh teknike, p.sh. cili është intensiteti i dritave? Dhe janë me mijëra pyetje të tjera. Komiteti Ndërministror, këto pyetje teknike, i kanë bartur te ne dhe ne iu kemi dhënë draftet e përgjigjeve në cilësinë tonë si ekspertë, ata janë përgjigjur. Koncesionari i aeroportit, pa marrë parasysh kush e ka në pronë dhe kush operon, ndaj shtetit sa u përket standardeve të sigurisë, i ka obligimet e njëjta. Asgjë nuk do të ndryshojë në raportet e AAC-së me Aeroportin e Prishtinës. Ata do të jenë të detyruar që të kenë numër të caktuar të personelit të trajnuar, do të jenë të detyruar që t'i mbajnë nivelet e caktuara të standardeve që, ju si Kuvend i keni caktuar përmes ligjit. Kemi pasur shumë edhe përkrahjen e këtij Kuvendi sa i përket shumë çështjeve, të Qeverisë, dhe besoj që përkrahjen tuaj do ta kemi edhe më tutje dhe ne do të jemi në dispozicionin tuaj për çfarëdo lloj çështjeje. Desha të shtoj edhe për aktivitetin e prokurimit, ky aktivitet nuk është kryer kurrë. Kemi pasur oferta të papërgjegjshme dhe nuk ka pasur as çmim, sepse nuk mund ta botojmë një çmim prej njerëzve të papërgjegjshëm. Prandaj i tillë ka mbetur, nuk pasqyrohet.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC për vitin 2009

dhe parashtron këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që ta mbështesë Raportin vjetor 2009 të Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC.

5. Të ndryshme

i) Plani i Veprimit i Kuvendit për Integrimin Evropian

Kryetarja – Kërkoj nga kryesuesja e grupit punues Nerxhivane Dauti që të ndërmarrin veprime konkrete për përmbushjen e kërkesave që dalin nga Plani i Veprimit për Integrimin Evropian dhe Komisioni në një afat sa më të shpejtë t'i paraqesë përfundimet për miratim dhe procedim.

Qamile Morina – Kërkoj që të lirohet nga grupi punues për shkak të obligimeve të tjera që është e ngarkuar.

Pas debatit të gjerë Komisioni nxori këtë

Përfundim

- i. *Grupit punues i udhëhequr nga Nerxhivane Dauti të vazhdojë aktivitetet në fushat përkatëse të Komisionit duke vlerësuar dhe përmbushur kërkesat që dalin nga Plani i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrimin European.*
- ii. *Nga Grupi punues lirohet Qamile Morina, ndërsa plotësohet më Fatmir Rexhepin. (Nerxhivane Dauti, Zef Morina dhe Fatmir Rexhepi)*

ii) Projektligjet në procedurë

Kryetarja – Kërkoi nga grupet e caktuara punuese për projektligjet e energjetikës që të intesifikojnë punën,

Në vazhdim propozoi që të formohet grupi punues për Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Formohet grupi punues prej Nerxhivane Dauti, kryesuese, Zef Morina, Ethem Çeku, dhe Fatmir Rexhepi për Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

iii. Monitorimi i ligjeve

Kryetarja – kërkoi që grupet punuese për monitorimin e ligjeve të plotësohen dhe të fillojnë punën.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

- i. *Grupit punues për monitorimin e Ligjit për telekomunikacionin, i udhëhequr nga Zef Morina, të plotësohet me Kaqusha Jashari dhe Ethem Çekun.*
- ii. *Grupi punues për monitorimin e Ligjit për naftë i udhëhequr nga Myzejene Selmani, të plotësohet me Ethem Çekun, Sala Berisha – Shalën dhe Qamile Morinën.*

iii. Mbledhja e radhës

Kryetarja – Propozoi që për rendin e ditës së mbledhjes së radhës të sjellën Raportet e projektligjeve në procedurë për shqyrtim dhe miratim.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës rendi i ditës të jetë më këtë përmbajtje: a) Shqyrtimi Projektligjit për inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese nr.L-181; b) Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e

topografisë së qarqet te integruara nr.L-165 dhe c) Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik nr.L-166.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00

E përgatiti:

Njësia e Mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani